



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT  
BASHKIA BERAT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Data 01. 03 .2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**Blerje produkte ushqimore per kopshtet cerdhet dhe konviktin”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):  
(FPP)\_15884000-8** ushqim per femije

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 38 756 848,6 ( tridhjetë e tetemilion e shtateqindë e pesedhjetë e gjashtë mijë e teteqind e dyzete e tete presjegjashte ) leke pa Tvsh  
2. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është \_21 747,50**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Qendra ekonomike e Arsimit , Bashkia Berat ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit,sipas shtojcës 8



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT  
BASHKIA BERAT

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare ,ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa vlera e përlogaritur e kontrates.

Kjo do të vërtetohet duke paraqitur vërtetim për xhiron lëshuar nga administrata tatimore.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë

Bazohet në nenin 43,pika 2 ,gërma b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar :

\* në nenin 43 pika 1 të VKM 285/2021 ”Mbi Rregullat e Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;

\* si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi tëArdhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve tre viteve të fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njepasnjeshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit [Nr. 8438](#), datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", Ligjin [Nr. 25/2018](#) datë 10.05.2018 "*Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*" , te Ligjit [Nr. 9920](#), datë 19.5.2008” Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*Neni 57*), Ligjit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT  
BASHKIA BERAT

Nr. 10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

- Licence te lëshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit, Kodi II.1.A(1) Prodhim, perpunim shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez.

- Liçencë te lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit, Kodi II.1.B, Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore (per njerez).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT  
BASHKIA BERAT

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 5 germa a, 5. “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

- a) *licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

*te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashket të APP-se dhe AKU-së nr.10181 prot, datë 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”*

2.3.2 Ofertuesi te paraqesë dokumentacion se disponon:

- 1- Magazine ushqimore dhe ambiente frigoriferike** në pronësi te pajisur me license QKL kodë II.1.B, akt-miratim higjeno sanitar, certifikaten e dezinfektimit 3D si dhe foto te ambjenteve te ushtrimit te aktivitetit ose ne rastet e disponimit me kontrate qiraje ose marreveshje furnizimi duhet te paraqitet kontrata e qirase /marreveshja e furnizimit e cila te tregojë qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit.
- 2- Furre buke** në pronësi/perdorim/marreveshje furnizimi te pajisur me leje higjeno sanitare, license QKL me kodin II.1.A.(1), si dhe certifikaten e dezinfektimit 3D si dhe raport analizen e ujit te rrjetit , ose ne rastet e disponimit me kontrate qiraje ose marreveshje furnizimi duhet te paraqitet kontrata e qirase / marreveshja e furnizimit e cila te tregojë qart lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit.
- 3- Njesi prodhimi bulmeti** ne pronesi/perdorim/marreveshje te pajisur me: leje higjeno sanitare, Leje mjedisore me kodin III.1. (per trajtimin dhe perpunimin e qumeshtit), License leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKB) me kodin II.1.A.(1) dhe II.1.B; ose ne rastet e disponimit me kontrate qiraje ose marreveshje furnizimi duhet te paraqitet kontrata e qirase / marreveshja e furnizimit e cila te tregojë qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit.
- 4- Thertore** ne pronesi/perdorim/marreveshje te pajisur me:leje higjeno sanitare, Leje mjedisore me kodin III.1 (therje kafshesh), License leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) me kodin II.1.A.(1) (thertore). Per thertoren te paraqitet vertetim nga AKU qe thertorja eshte funksionale (ne kuader te nismave qeveritare ne kete fushe); ose ne rastet e disponimit me kontrate qiraje ose marreveshje bashkepunimi duhet te paraqitet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT  
BASHKIA BERAT

kontrata e qirase ose marreveshje furnizimi e cila te tregoje qart lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit.

- 5- **Kompleks stallor** ne pronesi/perdorim/marreveshje te pajisur me certificate pronesie, Leje mjedisore me kodin III.1. (mbareshtim kafshesh), License leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) me kodin II.3.C; ose ne rastet e disponimit me kontrate qiraje ose marreveshje bashkepunimi duhet te paraqitet kontrata e qirase noteriale ose marreveshje furnizimi duhet te paraqitet kontrata e qirase / marreveshja e furnizimit e cila te tregoje qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit
- 6- **Kompleks pularie** ne pronesi/perdorim/marreveshje te pajisur me License leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) me kodin II.1.A. (prodhim, amballazhim, etiketim e shperndarje me shumice e vezeve), Leje mjedisore me kodin III.1. (rritje intensive e shpendeve). ose ne rastet e disponimit me kontrate qiraje ose marreveshje furnizimi duhet te paraqitet kontrata e qirase / marreveshja se furnizimit e cila te tregoje qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit.
- 7- **Sere** per prodhimin e perimeve te fresketa ne pronesi/perdorim/marreveshje te pajisur me: Dokument pronesie te seres dhe License leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKB) me kodin II.1.C; ose ne rastet e disponimit me kontrate qiraje ose marreveshje furnizimi duhet te paraqitet kontrata e qirase noteriale/ marreveshja se furnizimit noteriale e cila te tregoje qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 pika 1, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44 pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashket të APP-se dhe AKU-së nr.10181 prot, datë 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specififikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore. OE ofertues ne kete procedure prokurimi duhet te jete i pajisur me nje ambjent ne pronesi , me kontrate qiraje ose marreveshje bashkepunimi qe do te sherbej per magazinimin e produkteve te kerkurar ne preventiv, te cilet konsistojne ne shumellojshmeri produktesh per furnizimin sipas kerkesave te AK. Nje pjese e produkteve te kerkuara duhet te ruhen dhe ne kushte frigoriferike. Detyrimisht ambjenti duhet te plotesoj kerkesat ligjore ne fuqi te sipercituara. OE ofertues ne kete procedure prokurimi duhet te jete i pajisur me me nje ambjent per prodhimin e bukes ne pronesi ose me kontrate qiraje ose marreveshje bashkepunimi furnizimi sipas zerit ne preventiv. Kjo kerkese eshte pare e domosdoshme nga AK pasi kemi te bejme me furnizimim per kopshtet cerdhet dhe konviktin , furnizim i cili do te zgjase per nje periudhe 24 muaj dhe me qellim qe AK ti sigurohet besueshmeri nga ana e OE per permbushjen e plote te kontrates.Furri i bukes duhet te plotesoj kerkesat ligjore ne fuqi te sipercituara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT  
BASHKIA BERAT

OE ofertues ne kete procedure prokurimi duhet te jete i pajisur me Njesi prodhimi bulmeti ne pronesi ose me kontrate qiraje ose marreveshje bashkepunimi furnizimi sipas zerit ne preventiv(Djath, gjalp, qumesht, kos etj ). Kjo kerkese eshte pare e domosdoshme nga AK pasi kemi te bejme me furnizimim per kopshtet cerdhet dhe konviktin , furnizim i cili do te zgjase per nje periudhe 24 muaj dhe me qellim qe AK ti sigurohet besueshmeri nga ana e OE per permbushjen e plote te kontrates.Njesia per prodhimin e bulmetit duhet te plotesoj kerkesat ligjore ne fuqi te sipercituara.

OE ofertues ne kete procedure prokurimi duhet te jete i pajisur me Thertore ne pronesi ose me kontrate qiraje ose marreveshje bashkepunimi furnizimi sipas zerit ne preventiv(produkte mishi vici/pule dhe nenprodukte te tij sallam/salcice ). Kjo kerkese eshte pare e domosdoshme nga AK cdo gje e gjalle I nenshtrohet therrjes se ne ambjente te licencuara dhe te vulosura me vule veterineri.Thertorja duhet te plotesoj kerkesat ligjore ne fuqi te sipercituara.

OE ofertues ne kete procedure prokurimi duhet te jete i pajisur me Kompleks stallor ne pronesi, me kontrate qiraje ose marreveshje bashkepunimi furnizimi . sipas zerave ne preventiv jane kerkuar produkte mishi vici/pule Kjo kerkese eshte pare e domosdoshme nga AK per te siguruar qe gjeja e gjalle do te cohet ne thertore qe me pas do te sherbej per furnizim me nevoja per produkte mishit e jete rritur ne ambjente te specializuara per rritje dhe tregetim te gjes se gjalle.

OE ofertues ne kete procedure prokurimi duhet te jete i pajisur me Kompleks pularie ne pronesi, me kontrate qiraje ose marreveshje bashkepunimi furnizimi . sipas zerave ne preventiv jane kerkuar veze mish pule. Kjo kerkese eshte pare e domosdoshme nga AK pasi vezet e tregetuara duhet e jene te certifikuara sipas standartit te cilesise shoqeruara dhe me stamp gje te cilen e sigurojne vetem pularite. Kompleksi I pularise duhet te plotesoj kerkesat ligjore ne fuqi te sipercituara.

OE ofertues ne kete procedure prokurimi duhet te jete i pajisur me Sere ne pronesi, me kontrate qiraje ose marreveshje bashkepunimi furnizimi. Kjo kerkese eshte pare e domosdoshme nga AK pasi kemi te bejme me furnizimim per kopshtet cerdhet dhe konviktin , furnizim i cili do te zgjase per nje periudhe 24 muaj dhe me qellim qe AK ti sigurohet besueshmeri nga ana e OE per permbushjen e plote te kontrates.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy ) mjete transporti, nga te cilat 1 (nje) frigoriferike ATV për transportin e produkteve ushqimore. Nese mjetet jane në pronësi, të paraqitet dokumentacioni përkatës (certifikate pronesie) dhe të shoqëruar me lejen higjeno-sanitare, leje qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit, certifikate transporti (te paraqitet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT  
BASHKIA BERAT

automjet i cili pajiset me kete certifikate sipas legjislacionit ne fuqi), si dhe lejet e drejtimit te drejtuesve te mjeteve. Per mjetin e trete ne rast se eshte ne pronesi te paraqiten certifikate pronesie, leje qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshem te mjetit, certifikate transporti si dhe lejet e drejtimit te drejtuesve te mjeteve.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Automjeti nevojitet per transportin brenda normave higjeno-sanitare te lejuara te produkteve ushqimore objekt i kontrates

2.3.2.. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet të jenë te pajisur me certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të cilesise ISO 9001:2015, ose ekuivalente me to.

Certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore ISO 22000:2018, ose ekuivalente me to.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në **Rekomandim nr. 10181 prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”** të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Kriteri për certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të cilesise ISO 9001:2015, është vendosur në bazë të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion certifikimet e duhura per mallrat objekt prokurimi.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

2.3.6. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet të vetdeklarojnë që produktet e kërkuara plotësojnë standartet në fuqi për sigurinë ushqimore.

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT  
BASHKIA BERAT

Ndërsa, operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës ka detyrimin të paraqesë dokumentacion provues, ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Në rastet kur, operatorët ekonomikë nuk kanë detyrim ligjor të licencohen nga QKB duhet të paraqesin Ektraktin Tregtar, ku në fushën e veprimtarisë të jetë i përfshirë edhe objekti që prokurohet.

*Ne respektim te LPP-se ne te gjitha rastet kur permendet “marke” perfshihet termi “ ekuivalent ”.*

**Ofertuesi i kualifikuar i pari duhet te dorëzoje përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe brenda afatit te percaktuar ne kerkesen per dorezim dokumentacioni prane AK, dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të parashikuara në pikën 2 të nenit 26 te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

**II. Argumentimi i specifikimeve teknike** *Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose*

Perllogaritja e vleres se kontrates eshte pergatitur nga komisioni i perllogaritjes se vleres se fondit limit dhe specifikimet teknike jane hartuar nga specialistet e drejtiorise se arsmiit.

*Shenim : Ne rastet kur citohet ne specifikimet teknike termi “ Cilesia e pare”, ky percaktim eshte i barasvlefshem me termin “ ekuivalente”.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**





---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT  
BASHKIA BERAT

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**